




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.401/2021  
Datë: 8 dhjetor 2021

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores nr. 03/2021 për Rekurtimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen 273-të, të mbajtur më datë 8 dhjetor 2021, merr këtë:

### V E N D I M


- I. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1 nën pika 4 e dispozitivit të vendimit KGJK.nr.308/2021, të datës 1 nëntor 2021, sa i përket përbërjes së Komisionit për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, ashtu që në vend të gjyqtarit Fidan Hoxha, anëtar rezervë në komision, caktohet gjyqtarja Drita Rexhaj,
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 8 dhjetor 2021.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.308/2021, të datës 01.11.2021 ka emëruar Komisionin për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës ku ndër të tjerë anëtar rezervë të këtij komisioni ka emëruar gjyqtarin Fidan Hoxha.

Këshilli, ka shqyrtuar përbërjen e komisionit për rishqyrtim, për të cilin ka vendosur të ndryshoj dhe plotësoj, ashtu që në vend të gjyqtarit Fidan Hoxha, ka emëruar gjyqtaren Drita Rexhaj, anëtare rezervë të këtij komisioni, si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.